

## COVID 19. REFLEKTIME

**Artemisa Myrtaj**

**VITI I 2-të, Shkenca Juridike, UMSH**



"Duhet të shohësh të mirë në çdo të keqe", thotë një shprehje e cila është e njohur nga të gjithë!

Por sa e lehtë është ta shohësh këtë të mirë ndërkohë që çdo ditë dëgjojmë lajme te trishta nga situata aktuale që po kalon bota!?

Të gjithë ne, rrëmbyer nga jeta e shpejtë dhe monotonia e ditëve tona, nuk i kushtojmë rëndësi gabimeve që bëjmë. Kemi dëgjuar se Tokën, planetin tonë, po e shkatërrojmë dita ditës, dhe gjithçka çfarë kemi bërë ka qenë "një minut heshtje pendese" dhe kaq!

Shtresa e Ozonit është një zonë në stratosferën e Tokës e cila thith shumicën e rrezeve ultraviolett të Diellit. Pra, është një "çati" mbi kokat tona e cila na mbron. E çfarë bëjmë ne!? E shkatërrojmë atë çdo ditë si të ishte e dëmshme për ne.

Gjithashtu, pylli i Amazonës u dogj. Pylli tropikal i Amazonës, ishte një mrekulli ekologjike. Ishte zona më e madhe pyjore që i kishte mbetur botës. Amazona ishte shtëpia e të paktën 10% e biodiversitetit tonë, prodhonte 20% të oksigjenit në botë dhe ndihmonte për të rregulluar temperaturat e të gjithë planetit. Që në fillore kemi mësuar se: Pemët thithin karbonin dhe çlirojnë oksigjen. Pylli që u dogj nuk do të ketë më mundësi të thithë më të njëjtën sasi karboni e të çlirojë po të njëjtën sasi oksigjeni. Përfundimi është ndryshime klimatike. Uji çlirohet nga pemët në atmosferë dhe në oqean përmes lumenjve të Amazonës. Rrymat e oqeanit ndihmojnë në rregullimin e motit, transportimin e ujit të ngrohtë dhe reshjet nga ekuatori drejt poleve, dhe ujin e ftohtë nga polet në zonat e tropikut. Pa këto rryma, temperaturat rajonale do të ishin shumë më ekstreme.

Një dukuri tjetër e frikshme ishte zjarri i tmerrshëm i Australisë. Të gjithë themi se i duam kafshët por pamë gati 500 milionë gjitarë, zogj dhe zvarranikë pa jetë. Pamë në media kangurë që përpiqeshin të shpëtonin nga pyjet e djegura dhe trupa të djegur koalash të shtrirë në tokë. Mbyllëm sytë dhe vazhduam sërish jetën tonë të qetë.

Unë, kur isha një vajzë e vogël mësova për herë të parë termin "altruist". "Altruizmi është devocioni ndaj nevojave të të tjerëve duke flijuar apo hequr dorë nga interesi dhe e mira vetjake."

Me ardhjen e virusit, ne, "e keqja e madhe e natyrës", u bëmë altruist pa e kuptuar se po e benim. Me karantinimin e gjithë botës disa mrekulli te vogla filluan të ndodhin në natyrë. Me më pak makina në rrugë dhe fabrika të hapura, njerëzimi më në fund po i jep planetit një frymëmarrje shumë të nevojshme. Bimët po lulëzojnë në mjedisin tonë të ri më pak njerëzor, dhe kështu më pak toksik. Disa pamje tregojnë se janë shfaqur mjelma në kanalet e Venecias dhe gjithashtu delfinën janë shfaqur pa frikë në Tokën tonë të përbashkët. U shfaqën gjithashtu disa pamje disi komike të disa elefantëve të cilët flinin në një kopësht çaji. Ajo që dimë me siguri është se në mëngjes kur zgjohemi nga gjumi thithim ajër më të pastër. Po i lëmë hapsirë edhe banorëve të tjerë të Tokës, që ti gëzohen asaj. Nuk po ndosim më ambientin, nuk po ndezim më zjarre dhe me siguri, po lejojmë Tokën të marrë frymë. Ky virus i tmerrshëm do të përfundojë shumë shpejt, dhe shpresojmë me sa më pak dëme, por le të marrim një mësim të mirë nga e gjithë kjo! Le ta duam më shumë Tokën, ta duam më shumë vazhdimësinë e jetës e të vazhdojmë te jemi altruist, por kësaj rradhe me vetëdije!